



## Udhëzues në lidhje me plotësimin e formularit të kërkesës për pranim në Listën/Listat e Mbrojtësve

### 1. HYRJE:

Ky dokument shërben për të ndihmuar këdo që bën kërkesë për t'u pranuar në Listën/Listat e Mbrojtësve të Dhomave të Specializuara të Kosovës ("DHSK"), për plotësimin e formularit të kërkesës dhe dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm. Ky udhëzues bazohet në Direktivën për Mbrojtësit të cilin Administratorja e nxori më 6 nëntor 2017, me miratimin e Kryetares së Dhomave të Specializuara të Kosovës. Që prej asaj date është e hapur ftesa për kërkesat për pranim në Listën/Listat e Mbrojtësve.

Kërkesat për pranim në:

- **Listën e Mbrojtësve të Specializuar** i dërgohen Zyrës së Mbrojtjes të Zyrës Administrative të Dhomave të Specializuara të Kosovës;
- **Listën e Mbrojtësve të Viktimave** i dërgohen Zyrës për Pjesëmarrjen e Viktimave të Zyrës Administrative të Dhomave të Specializuara të Kosovës.

Vetëm mbrojtësit e pranuar në Listën e Mbrojtësve ose mbrojtësit që plotësojnë kriteret për pranim në Listën e Mbrojtësve mund të emërohen ose caktohen nga Administratorja në përputhje me Direktivën për Mbrojtësit, ose mund të zgjidhen si anëtarë të ekipit të një mbrojtësi dhe të punojnë si bashkëmbrojtës (shih Pjesën 18 të Direktivës për Mbrojtësit.

### 2. KRITERET E PRANIMIT

Për pranim në Listën/Listat e Mbrojtësve, kërkuesi duhet të plotësojë kriteret e Pjesës 5 të Direktivës për Mbrojtësit, konkretisht:

- kompetencë dhe përvojë të dëshmuar në fushën e së drejtës dhe procedurës penale vendore dhe/ose në fushën e së drejtës dhe procedurës penale ndërkombëtare;
- të paktën dhjetë (10) vjet (dhe si bashkëmbrojtës, të paktën shtatë (7) vjet) përvojë të dëshmuar përkatëse, qoftë si avokat i mbrojtjes apo i viktimave, si prokuror, gjykatës, ose në një funksion të ngjashëm në procese penale. Për pranim në Listën e Mbrojtësve të Viktimave, përfshihet të paktën pesë (5) vjet përvojë pune e dëshmuar në çështje penale me viktimë, përfshirë viktimat e cënueshme;
- gjatë gjithë kohës që është i përfshirë në Listën e Mbrojtësve, kërkuesi vazhdon të jetë anëtar i shoqatës së avokatëve ose i një institucioni të ngjashëm të vendit të tij, ose gjykatës dhe prokuror në varësi të një autoriteti mbikëqyrës;
- aftësi të komunikimit me shkrim dhe me gojë në një nga gjuhët zyrtare të Dhomave të Specializuara (shqip, anglisht, serbisht), sikurse përcaktohet në nenin 20 të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar;
- nuk është shpallur fajtor në procese penale, ose ndaj kërkuesit nuk janë marrë masa disiplinore në procedime disiplinore përkatëse kundër tij në ndonjë forum shtetëror ose ndërkombëtar, duke përfshirë edhe çfarëdo procedimi në bazë të Kodit të Etikës



Profesionale të gjykatave ndërkombëtare, përveç nëse gjykohet që, në rrethana të caktuara, do të ishte e tepruar që kërkuesit t'i refuzojnë pranimit mbi këtë bazë; dhe

- gjatë ushtrimit të profesionit ose në rrethana të tjera nuk ka pasur sjellje të pandershme ose diskredituese për një mbrojtës, në dëm të administrimit të drejtësisë, ose që ka gjasë të pakësojë besimin e publikut në Dhomat e Specializuara, ose në administrimin e drejtësisë, ose që diskrediton emrin e Dhomave të Specializuara. (Vendimi për pranimin në Listën e Mbrojtësve shtyhet në rast se janë në kryerje e sipër procedime, hetime dhe verifikime).

Në rast se ka më pak se dhjetë (10) vjet përvojë të dëshmuar përkatëse, por më shumë se shtatë (7) vjet përvojë të lartpërmendur, kërkuesi mund të përfshihet në Listën e Mbrojtësve, mirëpo mund të punojë vetëm si bashkëmbrojtës në rast se zgjidhet si anëtar i ekipit të një mbrojtësi të emëruar apo të caktuar (shih Pjesën 18 të Direktivës për Mbrojtësit).

Në bazë të Rregullores për Ndhimë Juridike, një mbrojtësi mund t'i kërkohej dokumente plotësuese kur shqyrtohet mundësia e caktimit të atij mbrojtësi, përfshirë edhe detyrën si mbrojtës kujdestar. Kushte ose kërkesa si këto do të bëhen të njohura dhe do të sqarohen pas miratimit të Rregullores për Ndhimë Juridike.

### **3. PROCESI I PARAQITJES SË KËRKESËS**

Kërkuesit duhet të dorëzojnë formularin e kërkesës të plotësuar si duhet së bashku me të gjitha dokumentet mbështetëse të nevojshme, sikurse përcaktohet në Pjesën 6 të Direktivës për Mbrojtësit.

Kërkesa për pranim në Listën e Mbrojtësve të Specializuar duhet të dërgohet në adresën elektronike: [defenceoffice@scp-ks.org](mailto:defenceoffice@scp-ks.org).

Kërkesa për pranim në Listën e Mbrojtësve të Viktimave duhet të dërgohet në adresën elektronike: [vpo@scp-ks.org](mailto:vpo@scp-ks.org).

Kërkesa për pranim në të dy listat duhet të dërgohet në të dyja adresat elektronike me anë të një mesazhi të vetëm.

### **4. VLERËSIMI I KËRKESAVE**

Pas marrjes së një kërkesë, Zyra e Mbrojtjes dhe/ose Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave verifikon nëse dokumentacioni i dorëzuar është i plotë dhe nëse kërkuesi i plotëson kriteret. Në rast se nevojitet informacion plotësues, zyra përkatëse kontakton me kërkuesin dhe cakton një afat për dorëzimin e informacionit plotësues. Në rast se kërkesa mbetet e paplotë, atëherë ajo refuzohet.

### **5. VENDIMI NË LIDHJE ME KËRKESAT**

Në rast refuzimi të një kërkesë për pranim në Listën e Mbrojtësve, kërkuesi njoftohet nëpërmjet një vendimi të arsyetuar. Kërkuesi mund t'i paraqesë Administratorit kërkesë për rishikimin e vendimit të marrë brenda katërmëdhjetë (14) ditësh nga njoftimi i vendimit. Brenda tridhjetë (30) ditësh nga marrja e kërkesës për rishikim, Administratori nxjerr një vendim të arsyetuar të formës së prerë.



## **6. MROJTËSI KUJDESTAR**

Në rastet kur ekziston nevojë e ngutshme për ndihmë juridike, një personi ose personave që gëzojnë të drejtën e përfaqësimit juridik në procese penale para Dhomave të Specializuar i ose u caktohet një mbrojtës kujdestar. Mbrojtësit që janë në Listat e Mbrojtësve, në formularin e kërkesës që kanë dorëzuar gjithashtu bëjnë të ditur nëse dëshirojnë të caktohen si mbrojtës kujdestarë. Mbrojtësit kujdestarë duhet të jenë menjëherë të disponueshëm dhe paguhen për punën në përputhje me Rregulloren për Ndihmë Juridike të Dhomave të Specializuara të Kosovës që do të publikohet më vonë. Puna e mbrojtësit kujdestar është për një periudhë të kufizuar dhe për një lëndë të caktuar.

## **SHTOJCË**

### **1. Formulari i kërkesës i shpjeguar për çdo pikë:**

#### **Pika 1:**

Sikurse tregohet në formularin e kërkesës, kërkuesi duhet të zgjedhë Listën e Mbrojtësve për të cilën bën kërkesë. Kërkesa mund të bëhet edhe për të dy listat. Në rast se kërkuesi ka më shumë se 10 vjet përvojë përkatëse të dëshmuar, atëherë duhet të zgjedhë opsionin “Mbrojtës”, në qoftë se kërkuesi ka më shumë se 7 dhe më pak se 10 vjet përvojë të dëshmuar përkatëse, atëherë duhet të zgjedhë opsionin “Bashkëmbrojtës”. Në qoftë se kërkuesi nuk është i sigurt nëse i përmbush kriteret, atëherë mund t’i zgjedhë të dy opsionet, duke treguar në këtë mënyrë se është i gatshëm të pranohet edhe si bashkëmbrojtës.

#### **Pikat 2-3:**

Kërkuesi duhet të japë informacion sa më të hollësishëm dhe të plotë individual dhe të dhënat e kontaktit personal. Duhet të shënohen të gjitha shtetësisë që ka kërkuesi si dhe të dhënat e kontaktit, ku të përfshihen edhe të dhënat e kontaktit të zyrës së avokatisë të kërkuesit, në rast se është e zbatueshme. Çfarëdo informacioni, p.sh., të dhënat e kontaktit të zyrave të ndryshme të avokatisë për të cilat ka punuar kërkuesi, që nuk mund të përfshihet në pikën 2 dhe 3, duhet të shënohet në pikën 9.c të formularit të kërkesës.

#### **Pika 4:**

Gjithashtu kërkuesi duhet të shënojë të gjithë informacionin përkatës në lidhje me studimet universitare që ka kryer dhe çfarëdo kursesh apo trajnime të tjera që vërtetojnë se zotëron kompetencë të dëshmuar në të drejtën dhe procedurën penale vendore dhe/ose atë ndërkombëtare, sikurse kërkohet në pikën a të Pjesës 5 të Direktivës.

#### **Pikat 5-7:**

Kërkuesi duhet të shënojë të gjithë informacionin që vërteton përvojën për përmbushjen e kriterëve në pikat a, b dhe c të Pjesës 5 të Direktivës për Mbrojtësit. Në pikën 5 të formularit duhet shënuar përvoja e tashme dhe/ose e shkuar si avokat në procese penale. Në pikën 6 shënohet përvojë e tashme dhe/ose e shkuar si gjykatës, prokuror apo jurist në procese penale. Pika 7 është në lidhje me funksione ose detyra të tashme dhe/ose të shkuara që nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me procese penale, ose që janë kryer në funksione nderi/për qëllime jofitimprurëse.

#### **Pika 8:**



Informacioni i dhënë në pikën 8.a.1. dhe 2 të formularit shërben për përmbushjen e kriterëve të pikës d të Pjesës 5 të Direktivës për Mbrojtësit. Edhe pse ky informacion mund të nxirret prej pikës 5 dhe pikës 6, një informacion i tillë dhe përgjigjet e qarta shkojnë në të mirë të qartësisë.

Informacioni i dhënë në pikën 8.a.3. të formularit, shërben për përmbushjen e kriterëve të pikës a dhe b të Pjesës 5 të Direktivës për Mbrojtësit dhe në rrethana konkrete të përcaktuara në pikën 2 të Pjesës 7 të Direktivës për Mbrojtësit, mund të shërbejë në mbështetje të një pranimi të kushtëzuar të një kërkuar në Listën/Listat e Mbrojtësve.

Në pikën 8.b. të formularit kërkohet dëshmi e aftësisë gjuhësore të kërkuar në një nga gjuhët zyrtare të Dhomave të Specializuara të Kosovës që ka lidhje me kriterin e pikës e të Pjesës 5 të Direktivës për Mbrojtësit. Kërkuar duhet të zotërojë aftësi të komunikimit me shkrim dhe me gojë në gjuhën shqipe, serbe ose angleze.

Në pikën 8.c të formularit kërkohet informacion që ka lidhje me pikat f dhe g të Pjesës 5 të Direktivës për Mbrojtësit.

#### **Pika 9:**

Pika 9 e formularit ofron mundësi që kërkuar të shënojë aftësi të tjera dhe hapësirë për çfarëdo informacioni që nuk mund të përfshihej në pjesë të tjera të formularit të kërkesës.

#### **Pika 10:**

Informacioni që jepet në pikën 10 të formularit, konkretisht shërben si dëshmi për përmbushjen e kriterit të pikës c të Pjesës 5 të Direktivës për Mbrojtësit. Edhe pse një informacion i tillë mund të jetë shënuar në pikat 5 dhe 6 të formularit, ky informacion duhet përmbledhur në pikën 10 të formularit, me qëllim që t'i mundësojë Zyrës për Pjesëmarrje të Viktimave të çmojë vlerën e kësaj përvoje.

#### **Pika 11:**

Në pikën 11 të formularit ofrohet mundësia për të shënuar të dhënat e kontaktit të dy rekomanduesve, sikurse kërkohet në pikën g të Pjesës 6 të Direktivës.

#### **Pika 12:**

Në përputhje me pikën 2 të Pjesës 6 të Direktivës për Mbrojtësit, në pikën 12 të formularit, kandidatëve u kërkohet të japin një numër deklaratash. Ju lutemi mbani parasysh se pas miratimit të Kodit të Etikës Profesionale të Mbrojtësve, njësia përgjegjëse e Zyrës Administrative do t'ju kontaktojë për dhënien e një deklaratë në përputhje me Pjesën 6, pika 2, nënpika d, të Direktivës për Mbrojtësit.

#### **Pikat 13 dhe 14**

Pika 13 trajton temën e publicitetit dhe pika 14 përmban deklaratat dhe vërtetimet që jep kërkuar kur dorëzon formularin e kërkesës.

## **2. Dokumente mbështetëse – Hollësi:**

Duke u bazuar në kriteret e parashtruara në Pjesën 5 të Direktivës për Mbrojtësit, për dorëzimin e një kërkesë për pranim në Listat kërkohen dokumentet e mëposhtme:

- Formulari i plotësuar i kërkesës;
- Kopje e lexueshme e një dokumenti për udhëtim/pasaportë;
- Vërtetim për vendbanimin;



- Vërtetim të anëtarësisë në një shoqatë shtetërore avokatësh, ose në një institucion të ngjashëm që konfirmon kualifikimet e kërkuesit si gjykatës, prokuror që varet prej një autoriteti mbikëqyrës, ku ndër të tjera përmendet çfarëdo mase disiplinore, ose procedimi, hetimi verifikimi në kryerje e sipër, nëse ka;
  - *Vërtetime të tilla kryesisht shërbejnë si prova të përmbushjes së kritereve të parashtruara në pikat d, f dhe g të Pjesës 5 të Direktivës për Mbrojtësit dhe duhen dorëzuar në mbështetje të informacionit të dhënë në pikën 8.a.1. të formularit të kërkesës.*
- Çfarëdo vërtetimi që tregon përvojën përkatëse të kërkuesit, ndër të cilat:
  - Vërtetime të një shoqate shtetërore të avokatëve ose institucioni të ngjashëm anëtar i së cilës ka qenë kërkuesi dhe/ose nga autoriteti mbikëqyrës i mëparshëm ose autoritetet mbikëqyrëse të mëparshme të kërkuesit.;
  - Vërtetime të një shoqate ndërkombëtare avokatësh ose një organizate apo institucioni ndërkombëtar/të ndërkombëtarizuar që mban një listë mbrojtësish ku kërkuesi është, apo ka qenë anëtar;
  - Vërtetime të një instance ose organizate vendore, ose një organizate apo institucioni ndërkombëtar/të ndërkombëtarizuar, ku kërkuesi është, ose ka qenë pjesëtar i personelitNë të gjitha vërtetimet e parashtruara përmendet në qoftë se është e mundshme përmendet çfarëdo mase disiplinore, ose procedimi, hetimi verifikimi në kryerje e sipër, nëse ka.
  - *Vërtetime të tilla kryesisht shërbejnë si dëshmi të përvojës përkatëse të kërkuesit në përmbushje të kritereve në pikat b dhe c si dhe f dhe g të Pjesës 5 të Direktivës për Mbrojtësit dhe duhen dorëzuar në mbështetje të informacionit që jepet në pikën 5 dhe pikën 7 të formularit të kërkesës.*
- Vërtetim nga autoriteti përkatës i shtetit shtetas i të cilit është personi, ose ku personi është me banim, që përmend çfarëdo vendimi për fajësi penale nëse ka;
  - *Vërtetime të tilla shërbejnë kryesisht si dëshmi të përmbushjes së kritereve të pikës f të Pjesës 5 të Direktivës.*
- dëshmi të aftësisë së komunikimit me shkrim dhe me gojë në një nga gjuhët zyrtare të Dhomave të Specializuara (shqip, serbisht, anglisht). Në rast se nuk është gjuhë amtare, mund të dëshmohet përmes dokumentimit të përvojës së punës dhe/ose një vërtetimi të një instituti gjuhësor;
  - *Vërtetime të tilla shërbejnë kryesisht si dëshmi të përmbushjes së kritereve të pikës e të Pjesës 5 të Direktivës për Mbrojtësit.*
- Dokumente (p.sh kopje të vërtetimeve) në mbështetje të informacionit të shënuar në pikën 4 të formularit të kërkesës (arsimi dhe trajnimi profesional).
  - *Dëshmi të tilla shërbejnë kryesisht në lidhje me përmbushjen e kritereve të pikës a të Pjesës 5 të Direktivës për Mbrojtësit.*
- Në qoftë se është e mundshme, dokumente në mbështetje të çfarëdo informacioni të shënuar nga kërkuesi në formularin e kërkesës.